me ActiFilm DOL

# Golamir

## 2ACT Pakëson dhimbjen dhe mbron fytin

100% FORMULË NATYRALE E BIODEGRADUESHME

gluten free

TË RRITUR DHE FËMIJË DUKE FILLUAR NGA MOSHA 1 VJEÇ

PAJISJE MJEKËSORE Klasa IIa CE 0477

### SPRAY PA ALKOOL

**AL Golamir 2Act spray pa alkool** është një Pajisje mjekësore inovative që qetëson dhimbjen dhe irritimin në sajë të një **veprimi anti-inflamator indirekt** dhe **mbrojtës** të mukozës orofaringeale. Këshillohet në rastet e dhimbjes së fytit për trajtimin e gjendjeve irrituese dhe inflamatore të cilat mund të shkaktohen nga viruset, bakteret, alergjenët ose nga kontakti me agjentë irritues të jashtëm (tymi, smogu, pluhuri). Produkti është gjithashtu i përshtatshëm në ftohje kur sekrecionet e hundës që zbresin në fyt mund të shkaktojnë irritim. **Golamir 2Act spray pa alkool** në sajë të kompleksit të tij aktiv natyral **ActiFilm DOL** vepron mbi dhimbjen, djegien dhe vështirësitë në gëlltitje duke e mbrojtur mukozën nga faktorët që shkaktojnë irritimin. **ActiFilm DOL**, i përbërë nga tanine, rrëshira, polisakaride dhe flavonoide, formon një **film aktiv me efekt barrierë**, me një veprim të dyfishtë:



**mbron sipërfaqen mukozale** për të zvogëluar mbindjeshmërinë



normalizon mukozën nëpërmjet një **aktiviteti anti-inflamator indirekt**

Fraksionet e tanineve dhe të rrëshirave që gjenden në **Golamir 2Act spray pa alkool** krijojnë gjithashtu një ambient të papërshtatshëm për rritjen e baktereve. Produkti është 100% natyral, pa gluten dhe me shije të këndshme të Frutave të pyllit dhe Manaferrave.

**UDHËZIME: Golamir 2Act spray pa alkool** këshillohet në rastet e dhimbjes së fytit për trajtimin e gjendjeve irrituese dhe inflamatore të zgavrës orofaringeale, të cilat mund të shkaktohen nga viruset, bakteret, alergjenët ose nga kontakti me agjentë irritues të jashtëm (tymi, smogu, pluhuri). Produkti është gjithashtu i përshtatshëm në ftohje kur sekrecionet e hundës që zbresin në fyt mund të shkaktojnë irritim. **Mund të përdoret nga mosha 1 vjeç e sipër. Golamir 2Act spray pa alkool** për shkak të mekanizmit të tij të veprimit mund të përdoret gjithashtu duke e shoqëruar me trajtimet farmakologjike të përshkruara nga mjeku.

**PËRBËRJA - Substancat funksionale: ActiFilm DOL,** kompleks aktiv natyral i përbërë nga: një fraksion taninik dhe flavonoidik nga Agrimonia, fraksion polisakarid nga xheli fletë i Aloe vera dhe fraksion i rrëshirave nga Mirra.
**Përmban gjithashtu:** Glicerinë vegjetale, Ujë, lëng Molle, lëng Limoni, aroma natyrale të Frutave të pyllit dhe Manaferrave, gomë ksantan.

**MËNYRA E PËRDORIMIT** - Rekomandohet të aplikohet në zgavrën orofaringeale:
- **4 spërkatje deri në 4 herë në ditë te fëmijët (nga 1 deri në 6 vjeç);**
- **4 spërkatje deri në 8 herë në ditë te të rriturit dhe fëmijët (mbi 6 vjeç).**

Te fëmijët më të vegjël, produkti mund të spërkatet në anët e brendshme të faqeve, në mënyrë që të lehtësohet gradualisht marrja e tij. Tundeni flakonin përpara përdorimit. Kutia përmban spërkatësin në një qese të mbyllur hermetikisht. Në përdorimin e parë, hiqni kapakun prej alumini mbi flakon dhe vendosni spërkatësin.

**PARALAJMËRIME:** nuk duhet përdorur nëse keni mbindjeshmëri ose alergji individuale ndaj një ose më shumë përbërësve. Nëse simptomat vazhdojnë, këshillohuni me një mjek. Të ruhet në temperaturë ambienti, larg burimeve të nxehtësisë dhe të mbrohet nga drita.
Të mbahet larg fëmijëve. Data e skadimit i referohet produktit të paprekur dhe të ruajtur në mënyrë korrekte.

**PAKETIMI:** flakon qelqi me 30 ml me spërkatës spray.

**SKADIMI:** shihni datën e shtypur mbi ambalazh. Mos e përdorni pas datës së skadimit të paraqitur. Këshillohet përdorimi i produktit brenda 3 muajve nga hapja e flakonit.

**DATA E REVIZIONIMIT TË FUNDIT:** 12/2017



### PËR SHËNDETIN SOT DHE NESËR

Aboca është një Shoqëri Benefit dhe është e certifikuar B Corp.
Ne jemi të përkushtuar të veprojmë në një mënyrë të përgjegjshme, të qëndrueshme dhe transparente ndaj komunitetit dhe ambientit. Relacioni i ndikimit është i disponueshëm në faqen e internetit www.aboca.com

**100% natyral dhe i biodegradueshëm**, Golamir 2Act spray pa alkool nuk përmban substanca sintetike, gjysmë sintetike ose të modifikuara gjenetikisht.

**Aboca S.p.A. Società Agricola** - Località Aboca, 20 - 52037 Sansepolcro (AR) Italia - **www.aboca.com**

Ndërmarrje me sistem të administrimit të cilësisë ISO 9001 e ISO 13485 dhe sistem të administrimit ambiental ISO 14001 të certifikuar.

Certified B Corporation

**MATERIALE AMBALAZHIMI**

| | | |
|---|---|---|
| **Paketim** | PAP 21 | Letër |
| **Fletëpalosje** | PAP 22 | Letër |
| **Flakon** | GL 72 | Qelq |
| **Spërkatës** | C/PP 92 | Kryesisht plastikë |
| **Bustinë** | PP 5 | Plastikë |
| **Tapë** | C/ALU 90 | Kryesisht alumin |

**Për eliminimin, verifikoni dispozitat në zonën tuaj të banimit.**

with ActiFilm DOL

# Golamir

## 2ACT Reduces pain and protects the throat

100% NATURAL AND BIODEGRADABLE FORMULA

gluten free

ADULTS AND CHILDREN FROM 1 YEAR OLD

MEDICAL DEVICE Class IIa CE 0477

## NO-ALCOHOL SPRAY

EN **Golamir 2Act no-alcohol spray** is an innovative Medical Device that soothes pain and irritation through an **indirect anti-inflammatory action** that **protects** the oropharyngeal mucosa. It is indicated for sore throats to treat irritation and inflammation caused by viruses, bacteria, allergens or contact with external irritants (smoke, smog, dust). The product can also be used for colds when post-nasal drip may cause throat irritation. Thanks to its natural active complex of **ActiFilm DOL, Golamir 2Act no-alcohol spray** acts on pain, burning and difficulty swallowing by protecting the mucosa from the factors that trigger irritation. **ActiFilm DOL**, consisting of tannins, resins, polysaccharides and flavonoids, forms an **active,** dual-action, **film that acts as a barrier** and:



**protects the mucosal surface**, reducing hypersensitivity



normalises the mucosa through **indirect anti-inflammatory activity**

The tannin and resinoid fractions in **Golamir 2Act no-alcohol spray** also create an unfavourable environment for bacterial growth.
The product is 100% natural, gluten-free and has a pleasant forest fruits and blackberry taste.

**INDICATIONS: Golamir 2Act no-alcohol spray** is indicated for sore throats to treat irritation and inflammation of the oropharyngeal cavity which may be caused by viruses, bacteria, allergens or contact with external irritants (smoke, smog and dust). The product can also be used for colds when post-nasal drip may cause throat irritation. **Can be used from 1 year of age**. Given its mechanism of action, **Golamir 2Act no-alcohol spray** can also be used concomitantly with medication prescribed by a doctor.

**COMPOSITION – Functional substances: ActiFilm DOL,** a natural active complex composed of tannin and flavonoid fraction from Agrimony, polysaccharide fraction from Aloe vera leaf gel and resinoid fraction from Myrrh.
**Also contains:** Vegetable glycerine, Water, Apple juice, Lemon juice, Forest fruits and Blackberry natural flavourings and Xanthan gum.

**INSTRUCTIONS FOR USE** - Administration in the oropharyngeal cavity is recommended:

- **4 sprays up to 4 times a day for children (from 1 to 6 years of age);**
- **4 sprays up to 8 times a day for adults and children over 6 years of age.**

In younger children, the product can be sprayed on the insides of the cheeks so that it can be taken gradually. Shake the bottle before use.
The box contains the nozzle in a sealed sachet. When using for the first time, remove the aluminium cap from the bottle and insert the nozzle.

**WARNINGS:** do not use in case of individual hypersensitivity or allergy to one or more components. If symptoms persist, seek medical advice.
Store at room temperature, away from heat sources and protected from light. Keep out of reach of children. The expiry date refers to the intact product, stored correctly.

**PACKAGE:** 30 ml glass bottle with spray nozzle.

**EXPIRY DATE:** see the expiry date stated on the pack. Do not use after the expiry date indicated. We recommend using the product within 3 months of opening.

**LAST REVISION DATE:** 12/2017



### FOR TODAY AND TOMORROW'S HEALTH

Aboca is a Benefit Corporation and certified B Corp.
We are committed to operating responsibly, sustainably and transparently towards the community and the environment. Impact report available at www.aboca.com

**100% natural and biodegradable**, Golamir 2Act no-alcohol spray contains no synthetic, semi-synthetic or genetically modified substances.

### PACKAGING MATERIALS

| | | |
|---|---|---|
| **Carton box** | PAP 21 | Paperboard |
| **Leaflet** | PAP 22 | Paper |
| **Bottle** | GL 72 | Glass |
| **Nozzle** | C/PP 92 | Predominantly plastic |
| **Sachet** | PP 5 | Plastic |
| **Cap** | C/ALU 90 | Predominantly aluminium |

**For disposal, please check the regulations in your local area.**

**Aboca S.p.A. Società Agricola** - Località Aboca, 20 - 52037 Sansepolcro (AR) Italia - **www.aboca.com**

Company operating under certifications ISO 9001 and ISO 13485 for quality management system and ISO 14001 for environmental management system.

Certified B Corporation

ALLEAGOMI-B